



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS FRËNGE**



PROGRAMI I LËNDËS

Gjuhë frënge e folur 2 (Niv B1-B2)

Ngarkesa: 4 kredite, 40 orë mësimore në klasë, 40 seminare

Viti akademik/semestri kur zhvillohet: Viti I /semestri II

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Bachelor në Gjuhë Frënge dhe Gjuhën e Shenjave Shqipe

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektiva të përgjithshme lëndore:

- Të thellojë njohuritë e marra paraprakisht
- Të zhvillojë kompetencën e të shprehurit me gojë
- Të jetë i aftë të kuptojë dhe ndërveprojë lirshëm në situata komunikimi
- Të përftojë njohuri më të thelluara mbi kulturën dhe qytetërimin frëng

Objektiva specifike lëndore:

- Të pasurojë dhe përdorë leksikun e ri në situata konkrete komunikimi duke iu përgjigjur tematikës së propozuar
- Të aftësohet për t'u shprehur lirshëm e rrjedhshëm në frëngjisht në situata përshkimore, shpjeguese interpretuese, duke përdorur saktë dhe me vend aspektet gramatikore të propozuara në këtë nivel.
- Të përmirësojë njohuritë lidhur me strukturat gjuhësore të gjuhës frënge dhe aspekte të tjera gramatikore dhe t'i përdorë ato me siguri në situata konkrete të propozuara nga metoda apo nga vetë ai.

Rezultate të pritshme:

- Të shprehet lirshëm dhe saktë në një gjuhë standarde frënge
- të aftësohet në situata ndërveprimi dhe komunikimi duke përdorur saktë aspektet gramatikore dhe leksikun e duhur
- Të thellojë njohuritë në aspekte të kulturës frënge